

Vlerat shpirtërore dhe bashkëpunimi ndërfetar në shërbim të paqes dhe mirëkuptimit



Vlerat shpirtërore dhe bashkëpunimi ndërfetar
në shërbim të paqes dhe mirëkuptimit

PËRSHËNDETJE E FORTLUMTURISË SË TIJ, † JOANI
Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë

Konferenca Ndërkombëtare Jubilare, e cila shënon tri përvjetorë të rëndësishëm për Komunitetin Bektashian: 35-vjetorin e rihapjes së Kryegjyshatës Botërore Bektashiane, 15-vjetorin e zgjedhjes së Kryegjyshit Botëror Haxhi Dede Edmond Brahimaj dhe 11-vjetorin e inaugurimit të Kompleksit Kulturor “Odeon”, na jep mundësinë t’ju shprehim urimet tona të singerta.

Rihapja e institucioneve fetare pas rënies së regjimit ateist ishte një ngjarje e madhe për mbarë vendin. Pas dekadash ndalimi dhe persekutimi, shqiptarët rifituan një të drejtë themelore: lirinë për të besuar, për të shprehur bindjet e tyre dhe për të organizuar jetën e bashkësive të tyre fetare. Kjo liri është një pasuri e përbashkët, të cilën kemi detyrimin ta ruajmë me përgjegjësi.

Ne u përkasim traditave fetare të ndryshme, me bindje dhe mësimet që nuk janë të

njëjta. Dialogu i ndershëm nuk kërkon t'i fshehim këto dallime, as t'i paraqesim besimet tona sikur të ishin të njëjta. Përkundrazi, ai kërkon që secili të jetë i sinqertë në besimin e vet dhe, njëkohësisht, i hapur për ta takuar tjetrin me respekt, pa frikë dhe pa paragjykim.

Gjatë gjithë këtyre viteve, marrëdhëniet ndërmjet Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Komunitetit Bektashian janë karakterizuar nga komunikimi i vazhdueshëm dhe i hapur. Jemi takuar në çaste gëzimi dhe në çaste vështirësie; kemi marrë pjesë në veprimtari e takime të përbashkëta; kemi shkëmbyer vizita dhe urime me rastin e festave të secilit komunitet. Sa herë ka qenë e nevojshme të përcillet një mesazh paqeje, qetësie dhe mirëkuptimi, kemi gjetur njëri-tjetrit të gatshëm për bisedë dhe bashkëpunim. Kryegjyshata Botërore Bektashiane ka qenë gjithmonë e hapur dhe e gatshme për këtë komunikim, dhe e vlerësojmë sinqerisht këtë qëndrim.

Këto takime nuk janë vetëm pjesë e mirësjelljes institucionale. Ato përcjellin një mësim të rëndësishëm të besimtarët e komuniteteve tona dhe të mbarë shoqëria: pavarësisht se cilës fe i përket dhe çfarë bindjeje ka secili, personi njerëzor duhet të respektohet, të dëgjohet dhe të trajtohet me dashuri. Bindja fetare nuk duhet dhe nuk mund të shndërrohet në arsye urrejtjeje, përçmimi apo dhune ndaj tjetrit.

Paqja fetare nuk ndërtohet duke heshtur për dallimet, por duke mos lejuar që dallimet të bëhen mure armiqësie. Ajo ndërtohet çdo ditë: me një fjalë të matur, me një takim të sinqertë, me një urim, me praninë pranë tjetrit në një çast të vështirë dhe me bashkëpunimin për çështje që prekin të gjithë qytetarët. Në këtë mënyrë, drejtuesit fetarë japin shembull se besnikëria ndaj traditës së vet mund të bashkëjetojë me respektin e thellë për lirinë dhe dinjitetin e tjetrit.

Kjo përgjegjësi bëhet edhe më e madhe sot, kur gjuha e urrejtjes, polarizimi dhe përçarja përhapen me shpejtësi, sidomos ndërmjet të rinjve. Detyra jonë e përbashkët është të mos lejojmë që feja të përdoret për të ndarë njerëzit, për të ndezur konfliktin apo për të justifikuar dhunën. Me fjalën dhe me shembullin tonë duhet të tregojmë se e ardhmja e Shqipërisë ndërtohet me liri, drejtësi, respekt të ndërsjellë dhe bashkëjetesë paqësore.

Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë do të vazhdojë në këtë rrugë: me identitet të qartë, me fjalë të sinqertë dhe me dorë të hapur për komunikim e bashkëpunim. Shpresojmë se edhe në vitet që vijnë marrëdhëniet tona me Kryegjyshitën Botërore Bektashiane do të vazhdojnë në të njëjtën frymë të mirëkuptimit, të respektit dhe të përgjegjësisë ndaj shoqërisë sonë.

Duke ju uruar mbarësi në punimet e kësaj konference, i shprehim Kryegjyshit Botëror, klerit bektashian dhe të gjithë besimtarëve të Komunitetit Bektashian urimet tona më të mira për këto përvjetorë jubilarë.

Konferenca Ndërkombëtare Jubilare,
Kryegjyshata Botërore Bektashiane,
Tiranë, 7 shtator 2026

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)